

Profili

Dr.Sllavka Kurti është diplomuar në vitin 2008 pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti Tiranës, në degën Administrim Biznes. Po në të njëjtin fakultet ka përfunduar edhe studimet Master të Nivelit të Dytë, në profillin Administrim Publik. Është pjesë e stafit akademik pranë Departamentit të Menaxhimit, Fakulteti i Ekonomisë prej vitit 2008. Ajo ligjëron në nivelin Bachelor lëndët Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Menaxhim Biznesi, ndërsa në programin master Administrim Publik European dhe Vlerësim i Politikave dhe Performancës në Sektorin Publik. Mban titullin Doktor Shkencash në Ekonomi prej vitit 2015, me objekt kërkimi cilësia e shërbimeve në organizatat e sektorit publik. Si kërkuese shkencore ka botuar disa artikuj në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, ka qenë pjesëmarrëse dhe ka prezantuar punime shkencore në shumë konferenca ndërkombëtare të mbajtura në Austri, Lituan, Republikë Çeke, Poloni, etj.

Ka marrë pjesë aktivisht në trajnime të ndryshme të organizuara nga universitete të huaja si, Meinheim(Gjermani), Bor (Serbi), Ruse (Bullgari), Mynih (Gjermani), Valladolid (Spanjë), Granada (Spanjë), Middlessex, Londër (Britani e Madhe), etj. Ajo është angazhuar si eksperte në projekte të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara nga IFC (Banka Botërore), IPA (Bashkimi European), Swiss Contact, etj.